



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:010343

Datë: 27.07.2018

Numri i dokumentit: 00091536

**P. nr.330/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjet penale kundër të akuzuarve **A. G.**, nga Prizreni, **B. G.** dhe **D. G.**, që të dy nga ....., K- Prizren, të akuzuar shkak të veprave penale vjedhje e rënd në bash kryerje e në vazhdimësi nga neni 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë, PP.453/17 të datës 22.05.2017, në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datë **13.07.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të dëmtuarve I. G., A. K., G. E. dhe të akuzuarve, **me dt.17.07.2018**, mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **A. G.**, i biri i B. dhe i H. e gjinisë B., data e lindjes ... në .... K Rahovec, tani me banim ne Prizren, "Rr."....., ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i gjendjes se mesme ekonomike, i martuar, shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës.

I akuzuari **B. G.**, i biri i Xh. dhe i F. e gjinisë O., data e lindjes ... në Prizren, tani me banim ne ..... K Prizren, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i gjendjes se mesme ekonomike, i martuar at i 2 fëmijëve, shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës.

I akuzuari **D. G.**, i biri i M. dhe i M. e gjinisë Xh., data e lindjes .... në ... K Prizren ku edhe tani banon, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i gjendjes se mesme ekonomike, i pa martuar, shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës.

**Bazuar ne nenin 364 par.1 nen par.1.3 te KPPK-së,**

**LIROHEN NGA AKUZA**

**Sepse :**

**I.**

- **me dt.27.01.2015, rreth orës 01,00 min**, ne ... K. Gjakove, me qëllim përfitimi të kundërligjshëm për vete apo tjetrin e me qëllim vjedhje, të marrun vesh mes veti më parë, me automjet "Audi" prone e të akuzuarit B., shkojnë të dyqani ushqimor prone e të dëmtuarit G. (D.) E. nga ....., ne atë mënyrë që kur shkojnë të akuzuarit A. e D. bëjnë roje, ndërsa i akuzuari B. me

prerës armature e prenë drynin e me kaçavide, e hape derën e dyqanit ,te tret futen brenda ne dyqan e vjedhin 3 (tre) komplete pije "Red Eagle "ne vlere prej 30.- Euro ,2 (dy) komplete pije "Coca Cola" ne vlere prej 20.- Euro, 1 (një) komplet pije "Fanta" ne vlere prej 10 euro ,30(tridhjetë) l.vaj ,ne vlerë 30 euro , mandarina ne vlerë prej 10 euro , 10 (dhjete) copa kvasac ne vlere prej 18 euro, keksa te ndryshme ne vlere prej 30 euro, cigare lloje te ndryshme ne vlere prej 100.euro,si dhe vjedhin 100 euro ,pare te gatshme ,ndërsa sendet e vjedhura i fusin ne paketa e i ngarkojnë ne automjet ,e largohen nga aty e i dërgojnë te shtëpia e te akuzuarit B. e i ndajnë.

## II.

- me dt.27.01.2015 rreth orës 03:00 min,.... K Gjakovë, me qellim përfitimi te kundërligjshëm për vete apo për tjetrin e me qellim vjedhje ,te marrun vesh ne mes vet me pare ,me automjet "Audi" prone e te akuzuarit B... ,shkojnë te dyqani ushqimore ,prone e te dëmtuarit I.(O.) G. nga ..., ne atë mënyrë qe kur shkojnë te akuzuarit A. e D. bëjnë roje ,ndërsa i akuzuari B. me prerës armature e prenë drynin e me kaçavide e hape derën e dyqanit , te tret futen brenda ne dyqan e vjedhin cigare lloje te ndryshme ne vlere prej 300 euro, kafe te llojit "Princ" në vlere prej 62 euro, si dhe te holla te gatshme ne vlere prej 15 euro, ndërsa sendet e vjedhura i fusin ne paketa e i ngarkojnë ne automjet e largohen nga aty e i dërgojnë te shtëpia e te akuzuarit B. e i ndajnë.

## III.

-me dt.17.02.2015 rreth orës 02:30 min,në .... me qellim përfitimi te kundërligjshëm per vete apo per tjetrin e me qellim vjedhje ,te marrun vesh ne mes me pare ,me automjet "Audi" prone e te akuzuarit B. ,shkojnë te dyqani ushqimore "B.." ,prone e te dëmtuarit A. (N.) K. nga ..., ne atë mënyrë qe kur shkojnë te akuzuarit A. e D. bëjnë roje ,ndërsa i akuzuari B. me prerës armature e prenë drynin e me kaçavide e hape derën e dyqanit , te tret futen brenda ne dyqan e vjedhin 10 (dhjete) kg Oriz ,20 (njëzet) pako makarona,1 (një)pako supe,1(një)pako topsa,1(një)pako kikirika,1(një) pako pashteta,5 (pese)litra alkool ,e te gjitha këto ne vlere te përgjithshme prej 150 euro, ndërsa sendet e vjedhura i fusin ne paketa e i ngarkojnë ne automjet e largohen nga aty e i dërgojnë te shtëpia e te akuzuarit B. e i ndajnë.

**- me çka do të kishin kryer veprën penale të vjedhjes së rënd në bashkëkryerje e në vazhdimësi nga neni 327 par.1pika1.1 e lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së.**

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore te kësaj gjykate

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë –Departamenti i Përgjithshëm , ka ngritur aktakuzën PP.nr.453/15 të dt.22.05.2017 ,kundër të akuzuarve A. G., nga Prizreni ,B. G. dhe D. G. , që të dy nga ....K- Prizren , të akuzuar shkak të veprave penale vjedhje e rënd në bash kryerje e në vazhdimësi nga neni 327 par1pika1.1lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik te mbajtur me dt.12.03.2018 Prokurorja e shtetit Ramiz Buzhala lexoi aktakuzën PP.nr 453/15 të dt. 22.05.2017 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe i propozoi gjykatës që pas administrimit të provave të akuzuarit të shpallen fajtor , të dënohen sipas ligjit dhe të obligohen ne pagesën e shpenzimeve procedurale .Në fjalën përfundimtare të mbajtur me dt.13.07.2018 Prokurori i shtetit Ismet Tofaj deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe provave të bashkëngjitura në aktakuzë , e gjykatës i le vlerësimin e këtyre provave duke menduar se me administrimin e provave është vërtetuar mjaftë gjendja faktike e përshkruar në

dispozitivat e aktakuzës dhe gjykatës i propozoi që të njëjtit të shpallen fajtor , të dënohen sipas ligjit dhe të obligohen në pagesën e shpenzimeve procedurale.

I dëmtuari I.G. ne fjalën përfundimtare deklaroi se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale me qene se nuk dyshojë ne këta persona dhe se nuk i njohë këta persona dhe se nuk i kam pare ndonjëherë dhe nuk kërkojë kompensim demi .

I dëmtuari A. K. ne fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet prokurorin e shtetit dhe kërkon kompensimin e demit .

I dëmtuari G. E. ne fjalën përfundimtare deklaroi se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale me qe këta persona asnjëherë nuk i kam pare dhe nuk i njohë dhe nuk kërkon kompensimin e demit .

I pandehuri A. G. ,gjate shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë sipas aktakuzës meqenëse nuk kam të bëjë fare me këto vepra me të cilat pandehem .Gjatë mbrojtjes së tij duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara ka theksuar se në stacionin policor jemi marr në pyetje të gjithë , unë nuk kam deklaruar asgjë , unë jam arrestuar dhe marr në pyetje nga ora 15.00 deri në ora 18.00 , pastaj ata e kanë lajmëruar avokatin dhe unë nuk kam qenë i informuar se ai është mbrojtësi im . Unë asnjëherë nuk kam qenë në ... dhe se të gjitha konstatimet në procesverbal janë bërë nga vet zyrtarët policor gjegjësisht nga polici V. K.. Në fjalën përfundimtare deklaroi mbetem ne tërësi pranë deklarimeve te cekura ne shqyrtimet gjyqësore dhe i propozoi gjykatës qe te lirohem nga akuza me qene se gjate shqyrtimit gjyqësor me asnjë prove nuk është vërtetuar se unë kam kryer veprat penale me te cilat akuzohem dhe ne mungesë te provave te merret aktgjykim lirues.

I akuzuari B.G. , gjate shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë sipas aktakuzës meqenëse nuk kam të bëjë fare me këto vepra me të cilat pandehem . Gjatë mbrojtjes së deklaroi se nuk e pranojë fajësinë për veprat penale për te cilat akuzohem me aktakuzë me qe nuk kam te beje asgjë me këto vepra ,me qene se edhe gjatë procedurës se provave me dëgjimin e te dëmtuarve dhe dëshmitarit nuk është provuar se unë jam kryes i këtyre veprave me te bashkakuzuarit tjerë , andaj i propozoi gjykatës qe te refuzohet akuza dhe te lirohem nga përgjegjësia penale . Gjatë mbrojtjes tij duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara ka deklaruar se nuk e di nga kush është iniciuar procedura por nga ju si prokuror i shtetit kërkojë drejtësi që të zbardhet e vërteta dhe jam në gjendje në çdo rast të përballem me këdo qoftë lidhur me rastin në fjalë . Arsyeya e mbrojtjes në heshtje në polici ka qenë mosbesimi në zyrtarët policor të cilët i ndërrojnë deklaratat dhe ne konsultim me mbrojtësin jam mbrojtur ne heshtje me qene se edhe fizikisht nuk isha ne gjendje te mirë shëndetësore ku edhe vet avokati me ka këshilluar qe te mbrohem ne heshtje. Në pyetjen e të dëmtuarit se a keni qenë ndonjëherë në .... ?ka deklaruar ndoshta kam kaluar andej pari meqenëse unë punojë në ndërtim por me emra nuk e di se cili fshatë është. Në fjalën përfundimtare deklaroi mbetem ne tersi pranë deklarimeve te cekura ne shqyrtimet gjyqësore dhe i propozoi gjykatës qe te lirohem nga akuza me qene se gjate shqyrtimit gjyqësor me asnjë prove nuk është vërtetuar se unë kam kryer veprat penale me te cilat akuzohem, ngase as nga dëshmitari apo te dëmtuarit e as me provat tjera nuk është vërtetuar fajësia ime andaj kërkojë nga gjykata te merr aktgjykim lirues .

I akuzuari D. G. , gjate shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë sipas aktakuzës meqenëse nuk kam të bëjë asgjë me këto vepra për të cilat akuzohem e kjo është vërtetuar edhe me rastin e marrjes ne pyetje te dëmtuarve si dhe dëshmitarit te cilët ne asnjë moment dhe asnjë dëshmi nuk kanë vërtetuar faktin se ne kemi kryer veprat penale për te cilat akuzohemi ,andaj i propozoi gjykatës qe te lirohem nga akuza . Në pyetjen e të dëmtuarit se a keni qenë ndonjëherë në .... ?ka deklaruar po ndoshta kur kam punuar me të akuzuarin B. G. në ndërtimtari. Në fjalën përfundimtare deklaroi mbetem ne tersi pranë deklarimeve te cekura ne shqyrtimet gjyqësore dhe i

propozoi gjykatës që të lirohem nga akuza me qene se gjate shqyrtimit gjyqësor me asnjë prove nuk është vërtetuar se unë kam kryer veprat penale me të cilat akuzohem, ngase as nga dëshmitari apo te dëmtuarit e as me provat tjera nuk është vërtetuar fajësia ime andaj kërkojë nga gjykata te merr aktgjykim lirues

Gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka nxjerr të gjitha provat e nevojshme dhe pas vlerësimit të secilës veç e veç dhe të dhe të gjitha së bashku në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit A. G., B. G. dhe D. G. nuk janë kryes të kryes të veprave penale që iu ngarkohet me aktakuzë meqenëse nuk është provuar se të njëjtit në bash kryerje kanë kryer veprën penale andaj konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP-ës , Gjykata ndaj të akuzuarve A. G. , B. G. dhe D. G. ,për veprën penale vjedhje e rënd në bash kryerje e në vazhdimësi nga neni 327 par.1 pika 1.1 – 31 dhe 81 të KPRK-ës , ka marr aktgjykim lirues.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga provat e administruara si dëshmia e dëmtuarve I. G., G. E. dhe A. K. , dëshmia e dëshmitarit D. K. si dhe ka administruar provat materiale dhe atë: si raportit fillestar me nr. rasti 2015-EA-112 dt.27.01.2015,raporti te oficerit me numër te njëjtë te rastit dt. 27.01.2015, raportit te këqyrjes se vendit te ngjarjes nga krim tekniku PK F. H. dt.27.01.2015 dhe fotoalbumi dt. 27.01.2015 nga vendi i ngjarjes ,raportit fillestar i incidentit me nr. rasti 2015-EA-215 dt.17.02.2015, raportit te oficerit me nr. te njëjtë te rastit dt, 17.02.2015, raportit te këqyrjes se vendit te ngjarjes dhe foto dokumentacionit te përpiluar nga krim tekniku S. Z. dt. 17.02.2015, raporti hetues nga oficeri hetues S. Sh. me nr. rasti 2015-EA-0113 ddt.25.03.2015i raporti fillestar te incidentit me nr. rasti 2015-EA-113 dt.27.01.2015,leximi i raportit te oficerit me nr. te njëjtë te rastit dt. 27.01.2015,leximi i raportit te këqyrjes se vendit te ngjarjes me nr. rasti 2015-EA-113 dt.27.01.2015 nga krim tekniku F. H. dhe fotoalbumit me numër dhe datë te njëjtë rastit ,certifikata e regjistrimit te automjetit .....ne emër te B. G.i nga .... ,me dt. të regjist.18.03.1987,prodhuesi “Audi “ tipi 89,ngjyre e artë metalike ,me tar. ....

I dëmtuari **I. G.**, në cilësi të dëshmitarit gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt.12.03.2018 ,ka deklaruar se në fsh . .... K-Gjakovë , kam lokalin –shitoren me gjëra ushqimore , ku me dt. 27.01.2015, kur jam ofruar te lokali me e hap kam vërejtur se dera ishte e hapur me dhunë , e kam parë derën , kam lajmëruar policinë të cilët më kanë thënë se jemi nja 500 m larg nga lokali meqë ishte lajmëruar edhe një rast i vjedhjes .Kemi hyrë së bashku me policinë dhe kamë vërejtur se më mungonte duhan, kafe , molla e gjithë çka është gjetur por edhe të holla të gatshme në vlerë afërsisht 20euro të cilat gjëra i kam cekur edhe në st.policor . Këta të akuzuarit këtu nuk më kujtohet se i kam pa ndonjëherë e as nuk kam pasur ndonjë mosmarrëveshje me këta 3 persona dhe se nuk dyshojë në këta tre persona .

I dëmtuari **A. K.** , në cilësi të dëshmitarit gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt.07.05.2018,ka deklaruar se në . K-Gjakovë , kam lokalin –shitoren me gjëra ushqimore ku edhe më herët më është bërë vjedhje e po ashtu gjatë vitit 2015, për të cilën jemi këtu , më janë vjedhur disa produkte si oriz, supa e gjësende tjera duhan nuk pasur meqenëse duhanin e kam larguar nga dyqani. Lokali është 200m , në rrugën kryesore të lagjes ku nuk ka ndriçim ,lokali ka qenë i mbyllur me hekura dhe ato ishin të lidhura njëra me tjetrën me dry të cilat i kanë këputur dhe e kanë demoluar derën edhe pse dera përveç çelësit i kishte edhe dy dryna .Lokalin e kam mbyllur atë ditë afërsisht në ora 22.00 dhe në ora 07.00 të mëngjesit e kam parë derën e hapur dhe e kam ftuar menjëherë policinë pa hyrë fare në lokal . Personat që i shoh këtu nuk i kam parë dhe gjersa unë nuk i kam parë nuk mund të them se janë këta që e kanë shkaktuar dëmin .

I dëmtuari **G. E.** , në cilësi të dëshmitarit gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt.07.05.2018,ka deklaruar se me dt. 27.01.2015, më është thyer lokali me gjëra ushqimore i cili

gjendet në .... afër restorantit ....” .Pasi e kam shtëpinë pas lokalit në mëngjes kur kam shkuar me e hap e kam parë se lokali ishte thyer pasi ishte me çelës dhe dry i mbyllur pa rrethoja, kam parë se dryni ishte prerë pa u dëmtuar brava por mekanizmi ishte i dëmtuar , në të cilin lokal më janë vjedhur të gjitha gjërat që ishin brenda e të cilat i kam deklaruar më herët në st. Policor . Personat që i shoh këtu nuk i kam parë ndonjëherë . Nuk dyshojë në këta persona pasi që unë nuk i kam parë askënd me sy .

Dëshmitari **D.K.** , gjatë dëshmisë se tij te dhënë gjate shqyrtimit j gjyqësor të mbajtur me dt. 07.05.2018 , duke u përgjigjur ne pyetjet e parashtruar ka deklaruar se isha duke ndenjtur tek pompa e benzinës me rojtarin e pompës, ka mund të jetë viti 2015, por saktë nuk e di cili muaj , nja 20-30 m pa u ofruar te dyqani i A.K. , kam takuar makinën me xhama të avulluara , rreth orës 02.25 pas mesnate , makina ishte në rrugë , e kanë ndezur makinën e cila ishte “Audi 80 “ ngjyrë e bardh ,makina nuk ka pasur targa të regjistrimit , por nuk kam pasur mundësi me vërejte se kush ishte dhe sa persona ishin edhe pse kam qenë shumë afër , në krah të makinës dhe kanë dal jashtë katundit pasi më kanë parë mua. Në pyetjen e prokurorit se ju në st. Policor keni deklaruar se makina ka qenë ngjyrë hiri e tani po thua e bardh dhe se kanë qenë 4 persona cili është e vërteta? dëshmitari ka theksuar se është kohë e gjatë nuk më kujtohet saktësisht se çka kam deklaruar por atë që e kam deklaruar në st. Policor është e vërteta , por nuk kam mundur me i pa drejt për drejt se ishin larg .Dëshmitari ka deklaruar se te shitorja e A. nuk kam parë që ka dal dikush nga makina por te shitorja tjetër që është e Sh. , kam parë që ka dal dikush nga makina dhe kanë shikuar dhe kanë hyp prapë në makinë por lokali i Sh. nuk është thyer.

Nga leximi i raporti i oficerit A. B. me ID .... , me nr.të rastit 2015-EA-112 të dt. 27.01.2015 i dt.12.05.2011,kostatohet se nga Baza me dt. 27.01.2015 rreth orës 08.00 janë njoftuar për një rast vjedhje të rënd në fah,. .... në dyqanin ushqimor të palës së dëmtuar G. E. në lagjen .... ku patrulla në përbërje nga A. B., hetuesi S. Sh. dhe krim tekniku F.H. kanë shkuar në drejtim të rastit si dhe konstatimi i tyre pas intervistimit të dëmtuarit e poashtu veprimet e hetuesit dhe krim-teknikut .

Nga leximi i Raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. të rastit 2015-EA-112 të dt. 27.01.2015 ,gjykata ka konstatuar arritjen në vendin e ngjarjes dhe përshkrimin e shkurtë nga krim tekniku PK. F. H. me ID ... dhe përmbledhja -fotografimi i vendit të ngjarjes dhe veprimi i tyre se është përdor pudër e zezë në sipërfaqe të ndryshme me qëllim të nxitjes së gjurmëve latente por në këtë rast nuk kemi gjetur latente të mira për punë teknike.

Nga foto-albumi 2015-EA-112 i dt.27.01.2015 në 8 faqe është bërë fotografimi i objektit dhe gjendjes në lokalin ku ka ndodhur rasti dhe mënyrën se si është bërë thyerjes së derës .

Nga leximi i raporti i oficerit R. A. me ID ... , me nr.të rastit 2015-EA-215 të dt. 17.02.2015 , konstatohet se nga Baza me dt. 17.02.2015 rreth orës 11.30 min janë njoftuar për një rast vjedhje të rënd në .... në dyqanin ushqimor” B..” të palës së dëmtuar A. K. lagjja e .... , ku patrulla në përbërje nga oficeri R. A. , hetuesi D.K. dhe krim tekniku Sh.Z. me ID..., kanë shkuar në drejtim të rastit si dhe konstatimi i tyre pas intervistimit të dëmtuarit e po ashtu veprimet e hetuesit dhe krim-teknikut .

Nga leximi i Raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. të rastit 2015-EA-215 të dt. 17.02.2015 ,gjykata ka konstatuar arritjen në vendin e ngjarjes dhe përshkrimin e shkurtë nga krim tekniku PK. Sh. Z. me ID ... dhe përmbledhja -fotografimi i vendit të ngjarjes ashtu siç është gjetur me kamer digjitale, kanë kërkuar gjurmë të mundshme në vende ku dyshohet se kanë prekur të dyshimit por pa rezultat .

Nga foto-albumi me nr. të rastit 2015-EA-215 i dt.17.02.2015, në 5 faqe, është bërë fotografimi i objektit dhe gjendjes në lokalit ku ka ndodhur rasti dhe mënyrën se si është bërë thyerjes së derës së lokalit.

Nga leximi i raportit i oficerit A.B. me ID ... , me nr.të rastit 2015-EA-113 të dt. 27.01.2015 , konstatohet se nga Baza me dt. 27.01.2015 rreth orës 08.25 min janë njoftuar për një rast vjedhje të rënd në ... në dyqanin ushqimor të palës së dëmtuar I. G. në lagjen e G. , ku patrulla në përbërje nga A.B., hetuesi S. Sh. dhe krim tekniku F. H. kanë shkuar në drejtim të rastit si dhe konstatimi i tyre pas intervistimit të dëmtuarit e po ashtu veprimet e hetuesit dhe krim-teknikut .

Nga leximi i Raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. të rastit 2015-EA-113 të dt. 27.01.2015 ,gjykata ka konstatuar arritjen në vendin e ngjarjes dhe përshkrimin e shkurtë nga krim tekniku PK. F. H. me ID ... dhe përmbledhja -fotografimi i vendit të ngjarjes ashtu siç është gjetur dhe veprimi i tyre se është përdor pudër e zezë në sipërfaqe të ndryshme me qëllim të nxitjes së gjurmëve latente por në këtë rast nuk kemi gjetur latente të mira për punë teknike.

Nga foto-albumi me nr.të rastit 2015-EA-113 i dt.27.01.2015, në 7 faqe, është bërë fotografimi i objektit dhe gjendjes në lokalit ku ka ndodhur rasti dhe mënyrën se si është bërë thyerjes së derës së lokalit

Nga leximi i certifikatës mbi a e regjistrimit te automjetit ...., gjykata konstatoi se automjeti emër te B. G. nga ....K Prizren ,me datë të regjistrimit që nga 18.03.1987, prodhuesi “Audi “ tipi 89 dhe është me ngjyrë të artë metalike ,me tar. ....

Gjykata pasi i ka analizuar të gjitha provat në rastin konkret ka konstatuar se nuk është kontestues fakti lokalet e të dëmtuarve G. E. dhe I. G. .... K-Gjakovë , me dt. 27.01.2015 janë thyer , ku nga aty janë vjedhur gjësende ushqimore si dhe me dt. 17.02.2015 , është thyer lokali “B.” i të dëmtuarit A. K. në ... , K-Gjakovë, po ashtu aty janë vjedhur gjësende ushqimore të përshkruara në dispozitivat e aktakuzës, mirëpo Gjykata me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetoj faktin se të akuzuarit në bash kryerje kanë kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë, ngase vetë i dëmtuari I.G. gjatë dëshmisë së tij ka theksuar se nuk dyshoj në këta persona meqenëse të njëjtit asnjëherë nuk i kam parë në jetën time . Poashtu i dëmtuari A. K. , gjatë dëshmisë së tij ka theksuar se këta persona nuk i kam parë e gjersa nuk i kam parë nuk mund të them se janë këta këtu të akuzuarit. I dëmtuari G. E. gjatë dëshmisë së tij ka theksuar se këta persona nuk i kam parë ndonjëherë .

Gjykata ka vlerësuar edhe deklaratën e të dëshmitarit D. K. , i cili gjatë dëshmisë së tij ka theksuar se isha te pompa e benzinës kur pa u afruar te lokali i A. K. nja 20-30 m, ka takuar makinën “Audi 80” me xhama të errëta ngjyrë e bardh të paregjistruar , ku të njëjtit e kanë ndezur menjëherë dhe kanë dal jashtë katundit pasi më kanë parë mua dhe se nuk e di sa persona ishin në veturë , gjykata ka ardhë në përfundim se deklaratës së të dëshmitarit D. K. nuk mund t’i falet besimi i plotë për shkak se dëshmia e tij nuk është kuptim plote dhe ajo çka është shumë me rëndësi deklarata e tij nuk është në harmoni me deklaratën e mëparshme të dhënë para oficerëve policor ku ka deklaruar se isha duke shkuar në shtëpi ka takuar një vetur Audi 80, ngjyrë hiri pa tabela ku në atë veturë ishin 4 persona, pasi u ndal vetura njëri nga ata ka dal nga vetura me një dritë shkrepsë duke shikuar shitoret , më pas ka vazhduar , unë isha këmbë dhe vërejtja se shitoren e kujshisë e kishin thyer , andaj gjykata përmes deklaratës së tij nuk ka mundur të vërtetoj faktin se të akuzuarit kanë kryer veprat penale , meqenëse gjykata ka vërtetuar faktin se nga i akuzuari B.G. sipas certifikatës së regjistrimit të automjetit ... ,ka në pronësi automjetin “ Audi “tipi 89 ngjyrë e artë metalike të regjistruar që nga viti 1987, jo “Audi 80” me ngjyrë të bardh apo ngjyrë hiri.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar me kujdes pretendimet e prokurorit të parashtruara në aktakuzë e edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor , i cili aktakuzën e ka mbështetur vetëm në deklaratën e të akuzuarit A.G. të dhënë në st. Policor, për rastin me nr. 2015-EA- 112 me dt. 02.04.2014 për rastin nr. 2015-EA-215 me dt. 02.04.2015 dhe për rastin nr. 2015-EA-113 me dt.02.04.2015 dhe se aktakuza nuk është bazuar në asnjë provë apo në ndonjë dëshmi tjetër të vetme .

Duke pas të gjitha këto rrethana , faktet e shqyrtuara dhe me provat e vërtetuara , Gjykata morri aktgjykim lirues për faktin se nuk ekziston asnjë provë tjetër (përpos deklaratës së të akuzuarit A. G. e dhënë në st. Policor), e cila do ta vërtetonte se këtu të akuzuarit kanë kryer veprat penale në bashkëkryerje për te cilat akuzohen sipas aktakuzës. Gjykata duke u bazuar posaçërisht në nenin 262 par.2 të KPPK-së , me të cilin është përcaktuar se të akuzuarit nuk mund të shpallen fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare vetëm deklaramit të akuzuarit A. G. në polici ose para prokurorit të shtetit , bazuar në nenin 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK-së ,te akuzuarit A. G., B. G. dhe D. G. , i ka liruar nga aktakuza për veprën penale vjedhje e rënd në bashkryerje në vazhdimësi nga neni 327 par.1 -1.1lidhur me nenin 31-81 të KPRK-ës.

Vendimi për udhëzimin e te dëmtuarve në kontest civil për realizimin e kërkesave pasurore juridike ,është marr bazuar ne nenin 463 par.3 te KPPK-së.

Vendimi qe shpenzimet e procedurës penale ,te bien ne barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës ,është marr bazuar ne nenin 454 par.1 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr. 330/17 të dt.17.07. 2018.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij në dorëzim , Gjykatës se Apelit në Prishtinë . Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.